KB

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË**
**DREJTORIA E NDIHMËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL**

Nr. 9857 prot. Vlorë, më 20.05 2026

**PROJEKTVENDIM**

Nr. ____ datë ______2026

**PËR**
**DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR MUAJIN PRILL 2026**

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 9 pika 1/1 a dhe 1/1 b, neni 24, neni 30 pika 6, neni 54, pika "k" dhe "n"; Ligji nr. 57/2019, datë 18.07.2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë" neni 21; Vendimi nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit të kushtëzuar" kreu 4 pika 1, si dhe VKB nr. 100, datë 23.12.2025, "Mbi miratimin e buxhetit për vitin 2026", VKB nr. 4 datë 30.01.2025 "Mbi miratimin e kritereve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën dhe nga fondet e Buxhetit Vendor" dhe në bazë të materialit të paraqitur nga Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social, Këshilli i Bashkisë Vlorë në mbledhjen e datës ___/05/2026 ;

**V E N D O S I:**

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin Prill 2026 gjithsej 17 familje me një fond prej 60.866 (gjashtëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.
2. Familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar sipas njësive janë:

| Nr | Njësitë administrative | NDIHMË | EKONOMIKE |
|---|---|---|---|
| | | nr | |
| 1 | Qendra e Bashkisë Vlorë | 17 | 60.866 |
| | **Totali** | **17** | **60.866** |

Familjet përfituese janë në listën emërore bashkëlidhur materialit .

Adresa : Sheshi "4 Heronjtë", www.vlora.gov.al; e-mail: info@vlora.gov.al

3. Masa e pagesës për familjet përfituese përllogaritet sipas V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Per përcaktimin e kritereve,të proçedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" kreu IV, pika 1.
4. Ndihma ekonomike të fillojë në datën 01.05.2026 dhe pagesa të bëhet mbas datës 31.05.2026.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Menxhimit Financiar dhe Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social .

6. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 55 pika 6.

**KRYETAR**

**Brunilda Mersini**

**ME URDHËR DELEGIMI**
**NËNKRYETAR**

**Joljana Llanaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VLORË